



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39/2019 (JR)  
Nr. 39/3 regj.

Tiranë, më 07.12.2020

**SHPLLJE**

**E**

**NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 07.12.2020, ora 11:30, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 39/2019, datë 04.09.2019, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Evelina Qirjako kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 178, datë 08.07.2019, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, ditën **e mërkurë**, në datën **23.12.2020**, ora **10:00**, për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit Evelina Qirjako të dëgjohet në gjykimin e çështjes.

Kërkesa e subjektit të rivlerësimit Evelina Qirjako për pezullimin e çështjes deri në zgjidhjen përfundimtare të padisë që ajo ka ngritur në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas specifikimeve të treguara në kërkesë do të shqyrtohet nga trupi gjykues gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesues i Trupit Gjykues**  
**Relatore e Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtar**  
**Gjyqtare**

**Sokol Çomo**  
**Rezarta Schuetz**  
**Albana Shtylla**  
**Ardian Hajdari**  
**Natasha Mulaj**

Bazuar në nenin 460, pika 5 të Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTAR**

**SOKOL ÇOMO**

